



Znj. Liljana Brahja ka lindur në Tiranë, më 26.10.1961. Ka kryer studimet e larta në Financë, në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Znj. Brahja, ka një përvojë pune prej 13 vitesh në INSTAT, përkatësisht nga viti 2008 deri në vitin 2019 ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Financës dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Financës dhe Projekteve.

Gjithashtu, Znj. Brahja ka një eksperiencë të gjerë pune në sektorin publik. Ajo ka punuar 6 vite në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, nga ku 4 vite në pozicionin e Drejtorit të Financës dhe Kontabilitetit, si dhe 2 vite në pozicionin e Përgjegjës të Financës dhe Kontabilitetit. Në vitet 1990-1998 ka ushtruar detyrën e Kryetarit të Degës së Financës në Bankën Tregtare Agrare si dhe përgjatë viteve 1984-1990 në kooperativën bujqësore “Myslym Peza”.

Znj. Brahja ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh mbi menaxhimin financiar, thithjen e investimeve të huaja, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, leadershipin etj.